

VENDIM
Nr.86, datë 13.9.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË FURNIZIMIT
PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “CEZ SHPËRNDARJE”
SHA PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUDHËN E TRETË
RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.80, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e “CEZ Shpërndarje” sh.a. për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarje” sh.a. për konsumatorët tariforë, për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarje” sh.a. për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani